



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

Nr. 01, datë 27.01.2014

Për miratimin e Kodit të Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma "e" dhe pika 16 si dhe të nenit 47, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", Autoriteti i Mediave Audiovizive,

V E N D O S I:

1. Miratimin e "Kodit të Transmetimit", sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen e internetit të AMA-s.

Kryetar: Prof.As. Endirë BUSHATI

Zëvendëskryetar: Sami NEZAJ

Anëtarë: Suela MUSTA

Zylyftar BREGU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

KODI I TRANSMETIMIT I AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Miraturar me Vendimin nr. _____, dt. _____ Të AMA-s

HYRJE

Kodi i Transmetimit përmban dhe përcakton parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Kodi i Transmetimit është hartuar në zbatim të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013 *“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*. Struktura dhe përmbajtja e Kodit të Transmetimit mbështeten në parimet themelore të veprimtarisë së transmetimeve audiovizive, në standardet më të arritura profesionale bashkëkohore, në normat dhe kërkesat morale dhe etike, si dhe në praktikën e deritanishme të veprimtarisë audiovizive në vendin tonë.

Ky Kod Transmetimi mban parasysh rolin e rëndësishëm të Ofruesve të Shërbimit Mediatik Audioviziv, si mjete të pavarura informacioni dhe platforma mediatike të zhvillimeve publike, politike e shoqërore, që kryejnë funksion informativ, kulturor, argëtues dhe edukativ, si dhe rolin e funksionin e AMA-s si autoritet rregullator në fushën e transmetimeve audiovizive.

Kodi i Transmetimit ka për qëllim të sigurojë pavarësinë dhe paaësinë e veprimtarisë së OSHMA-ve, duke synuar që ato të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshme për rolin dhe përgjegjësinë e tyre në transmetimin e programeve në përputhje me respektimin e lirive e të drejtave themelore të njeriut, me standardet e parimet etike e morale të shoqërisë, me respektimin në mënyrë të veçantë të të drejtave të të miturve, respektimin e privatësisë, dinjitetit, pluralizmit, paaësisë etj.

Në thelb, Kodi i Transmetimit përmban parimet bazë të transmetimit, si dhe rregullon veprimtarinë audiovizive, pothuaj në të gjithë gamën e saj të shumë anshme e të larmishme në stadin aktual. Kodi është strukturuar në seksione të ndryshme që përfshijnë parime e rregulla për programet informative, për mbrojtjen e të miturve në programet e të gjitha llojeve, kundër dhunës së skajshme në ekran, për komunikimet e ndryshme tregtare, respektimin e dinjitetit, mbrojtjen e të dhënave personale e të personave me aftësi të kufizuara etj.

Rregullat e Kodit të Transmetimit nuk duhet të lexohen apo të zbatohen nga OSHMA-të në mënyrë të izoluar, por brenda kontekstit të Kodit në tërësi, të lidhura ngushtë me kuptimet e përgjithshme e të veçanta që ndërveprojnë e plotësojnë njëra-tjetrën në shërbim e funksion të së tërës

Kodi nuk synon të adresojë të gjitha rastet dhe situatat me të cilat OSHMA-të mund të përballen, duke qenë se disa situata të veçanta mund të mos jenë përmendur në mënyrë specifike në këtë Kod. Shembujt e përfshirë në Kod nuk janë shterues. Megjithatë, parimet, sikurse janë të përshkruara në seksionet e mëposhtme, duhet të bëjnë të qartë qëllimin për të cilin është hartuar ky Kod, si dhe të ndihmojnë ofruesit e shërbimeve mediatike të bëjnë gjykimet e nevojshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

BAZA LIGJORE

1) Kodi i Transmetimit, i hartuar dhe i miratuar nga AMA, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, vendos rregullat, standardet dhe praktikën e transmetimit në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

- Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, nenet 19, 20, 46, 51,52.
- Ligji nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8096, datë 29.04.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 9, datë 15.09.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, i ndryshuar.

2) Kodi i Transmetimit është hartuar në bazë të kërkesave që lidhen me veprimtarinë audiovizive në Bashkimin Europian, parashikuar nga Direktiva 2010/13 e BE-së (“Audiovisual Media Services Directive”).

3) Kodi i Transmetimit është hartuar në zbatim të akteve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut:

- “Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore” (e vitit 1998), neni 8, neni 9, neni 10 dhe neni 14.
- Konventa e OKB-së “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” (e vitit 1989).

**SEKSIONI 1
PARIMET THEMELORE**

Parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, e cila mbështetet në garantimin e lirisë dhe të pluralizmit të mjeteve të komunikimit audioviziv janë si më poshtëvijon:

1.1 Operatorët e shërbimit mediatic audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, garantojnë dhe respektojnë lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit.

1.2 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- 1.3 Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut.
- 1.4 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.
- 1.5 Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin intolerancën ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve.
- 1.6 Transmetimet audiovizive duhet të respektojnë pluralizmin dhe paanësinë në politikat editoriale.
- 1.7 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton normat morale dhe etike të shoqërisë, si dhe kërkesat e deontologjisë së profesionit të gazetarit
- 1.8 Në transmetimet audiovizive respektohen të drejtat e autorit dhe të drejta të lidhura me të dhe standardi letrar i gjuhës shqipe.
- 1.9 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton veçanërisht të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
- 1.10 Transmetimet audiovizive respektojnë privatësinë dhe garantojnë të drejtën e përgjigjes.
- 1.11 Transmetimet audiovizive realizojnë një larmi përmbajtjeje e informacioni duke respektuar lirinë e konkurrencës dhe duke shfrytëzuar mundësitë e zhvillimit teknologjik.
- 1.12 Transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve respektojnë të drejtën e barazisë dhe mos diskriminimit për çdo shkak të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar.
- 1.13 Transmetimet audiovizive nuk duhet të përmbajnë mesazhe të dëmshme, nxitje të krimit, dhunës fizike apo urrejtjes.
- 1.14 Transmetimet audiovizive që përmbajnë elemente të pornografisë apo dhunës së skajshme duhet t'u nënshtrohen rregullave të veçanta të një sistemi kontrolli, si ai i aksesit të kushtëzuar apo programeve të kriptuara.
- 1.15 Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv duhet të jenë të hapur ndaj ideve, opinionëve, tendencave e kahjeve të ndryshme politike, shoqërore, kulturore e fetare.
- 1.16 Transmetimet audiovizive duhet të ruajnë e të promovojnë veçanësitë etnike dhe trashëgiminë kulturore, artistike e mjedisore në nivel kombëtar e lokal.
- 1.17 Transmetimet audiovizive duhet të promovojnë dhe të mbrojnë mirëqenien, shëndetin e zhvillimin harmonik moral e fizik të të miturve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SEKSIONI 2
E DREJTA PËR PRIVATËSI NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE

Standardet dhe praktikat e transmetimeve audiovizive duhet të drejtohen nga parimi bazë i respektimit të privatësisë së individit si dhe i mbrojtjes së të dhënave personale të tij, duke i drejtuar OSHMA-të në zbatimin e rregullave të mëposhtme:

2.1 OSHMA-të, në veprimtarinë e tyre audiovizive, duhet të respektojnë parimin se e drejta për lirinë e shprehjes nuk duhet të tejkalohet deri sa të cenohet të drejtën e individit për të mbrojtur privatësinë, të dhënat e tij personale sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Kjo është një e drejtë themelore e njeriut, e përcaktuar në Kushtetutën e Shqipërisë.

2.2 OSHMA-të, në transmetimet e programet e tyre, nuk duhet të bëjnë publike imazhe, pamje, filmime, dokumente apo fotografi, që përmbajnë të dhëna personale apo cenojnë dinjitetin e individit, përveçse me miratimin etij.

2.3 Transmetimet audiovizive, sidomos programet informative, duhet të respektojnë të drejtën e personit për mosdiskriminim, për konfidencialitet vetjak e familjar, si dhe parimin e prezumimit tëpafajësisë.

2.4 OSHMA-të mund të transmetojnë filmime, imazhe dhe informacione nga mjedise private, shtëpi, spitale, burgje, institucione të tjera rehabilitimi, vetëm me pëlqimin e personave të përfshirë.

2.5 Publikimi i të dhënave personale të individëve të ndryshëm, mund të bëhet vetëm duke mbajtur parasysh rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, duke ruajtur balancën e interesave individ –publik.

2.6 Transmetimi nga OSHMA-të i të dhënave personale, të siguruar nga përdorimi i kamerave të fshehura ose pajisjeve të tjera të fshehta për të filmuar e dëgjuar, telefonat celularë, mesazhet ose e-mail vetjake të individëve, duhet të bëhet duke respektuar kërkesat e Udhëzimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nr. 9, datë 15.09.2010, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”.

2.7 OSHMA-të duhet të shmangin transmetimin e të dhënave shëndetësore, publikimin e detajeve të hollësishme në rastet e sëmundjeve apo fatkeqësive të rënda, përshkrimin e prirjeve apo zakoneve seksuale, si dhe përpunimin e të dhënave biometrike që cenojnë dinjitetin e personit.

2.8 OSHMA-të, në të gjitha programet e tyre, duhet të respektojnë me rigorozitet dhe përparësi të drejtat e privatësisë së të miturve, të dhënat personale të të cilëve janë objekt i një mbrojtjeje të veçantë.

2.9 Transmetimi, publikimi dhe përhapja e detajeve, me çdo mjet, i lajmeve apo pamjeve që identifikojnë një të mitur të përfshirë në një krim është i ndaluar.

2.10 Në transmetimet audiovizive, respektimi i parimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale duhet të zbatohet pa diskriminuar për shkaqe si raca, mosha, aftësia e kufizuar ose çdo shkak tjetër të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar.



SEKSIONI3 TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE DHE INTERESI PUBLIK

Praktika e deritanishme e transmetimeve audiovizive ka dëshmuar se ka gjithnjë një raport e marrëdhënie të ndërsjellë midis të drejtës për informim, të drejtës për privatësi dhe interesit publik. Vlerësimi i kuptimit dhe rrethanave përcaktuese të interesit publik në raport me të drejtën e publikut për informim duhet t'i drejtojë OSHMA-të në zbatimin e rregullave të mëposhtme:

- 3.1 Veprimtaria audiovizive duhet të mbrojë interesa publike të caktuara, të përcaktuara nga Direktiva 2010/13 e BE-së dhe akte të tjera të Bashkimit Europian, të tilla si diversiteti kulturor, e drejta për informacion, pluralizmi i medias, mbrojtja e të miturve, mbrojtja e konsumatorit, siguria dhe mbrojtja e publikut nga çorientimi etj.
- 3.2 OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh se shkelja e dispozitave të Kodit të Transmetimit mund të përlligjet vetëm kur mund të tregohet qartë se kjo është në shërbim të interesit publik.
- 3.3 OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh se gjetja, ekspozimi ose parandalimi i një krimi, skandali apo shpërdorimi me pushtetin përbën gjithashtu interes të lartë publik.
- 3.4 Në kuptim të këtij Kodi, interesi publik nuk duhet të justifikojë pasaktësinë dhe spekulimin, dhe as të ngatërrohet me informacionin sensacional për publikun.

SEKSIONI4 TRANSMETIMI I PROGRAMEVE INFORMATIVE

Veprimtaria informative audiovizive, pavarësisht nga operatori i shërbimit mediatik audioviziv që e ushtron, përbën në të gjitha rastet një shërbim me interes të përgjithshëm publik dhe zhvillohet në zbatim e në përputhje me parimet e kërkesat që vijojnë:

- 4.1 OSHMA-të, gjatë veprimtarisë së tyre informative, duhet të respektojnë dispozitat mbi lirinë e shprehjes dhe informacionit, si dhe mbi të drejtat e njeriut, të parashikuara në aktet e brendshme dhe ato ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
- 4.2 OSHMA-të duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre informative në përputhje me kërkesat e parashikuara nga Kushtetuta dhe legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, statutet dhe dokumentet e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve dhe ato të Këshillit të Europës, si dhe në zbatim të rregullave dhe normave që parashtrihen në këtë Kod.
- 4.3 Transmetimet audiovizive garantojnë të drejtën e çdo shtetasi për të marrë informacion.
- 4.4 Informacioni i transmetuar duhet të jetë i vërtetë, i saktë dhe i balancuar.
- 4.5 Informacioni i transmetuar duhet të jetë i drejtë dhe duhet të respektojë pluralizmin dhe diversitetin e mendimeve si dhe formimin e lirë të opinionit.
- 4.6 Të gjitha lajmet e transmetuara të njoftohen dhe të paraqiten në mënyrë objektive dhe të paanshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- 4.7 Gazetarët kanë të drejtë të mos e bëjnë publik burimin e informacionit.
- 4.8 OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë lajme që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik, që mund të nxisin vepra penale apo të cenojnë autoritetin e shtetit.
- 4.9 OSHMA-të nuk duhet të shfaqin njëanshmëri për ndonjë forcë politike gjatë ndarjes së kohës së transmetimit për veprimtaritë e subjekteve politike.
- 4.10 Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër.
- 4.11 OSHMA-të, në programet informative, nuk duhet të propagandojmë krimin, terrorizmin apo veprimtari të tjera që përdorin dhunën për qëllime sensacionale.
- 4.12 OSHMA-të duhet të jenë veçanërisht të kujdesshme në respektimin e të drejtave të fëmijëve në rastet e raportimit të sjelljeve të dhunshme dhe seksuale ndaj të miturve.
- 4.13 OSHMA-të nuk duhet të çorientojnë publikun, të keqpërdorin apo të shtrembërojnë deklaratat e bëra në kontekste të caktuara.
- 4.14 OSHMA-të duhet të respektojnë të drejtën e korrektimit dhe të përgjigjes, si dhe të drejtën e prezumimit të pafajësisë e të konfidencialitetit.
- 4.15 OSHMA-të kanë akses në informacion, por ai duhet të mbliidhet në mënyrë etike e ligjore dhe të raportohet me kulturë gjuhësore e profesionale.
- 4.16 OSHMA-të, në të gjithë hapësirën informative, duhet të respektojnë të drejtën e individëve për privatësi. Vetëm mbrojtja e interesave të shoqërisë (interesi publik) mund të justifikojë hetimet gazetareske që ndërhyjnë në jetën private të personit.
- 4.17 OSHMA-të duhet të marrin në konsideratë ndjeshmërinë e publikut në rastet e fatkeqësive, katastrofave, aksidenteve, duke i dhënë përparësi operacioneve të shpëtimit dhe jo pamjeve të rënda e të dhunshme.
- 4.18 OSHMA-të duhet të mbajnë gjithnjë parasysh se informacioni nuk mund të përdoret për përfitime personale të pronarëve, drejtuesve apo gazetarëve.
- 4.19 OSHMA-të në hapësirën informative nuk duhet të keqpërdorin grupet vulnerabël, por duhet promovuar një qasje pozitive ndaj grupeve vulnerabël (minoriteteve, grave të dhunuara, personave me aftësi të kufizuara etj.)

SEKSIONI 5
FËMIJËT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE

Çdo fëmijë gëzon të drejtën e marrjes së një informacioni të përshtatshëm, si dhe të drejtën e fjalës, të shprehjes së mendimit dhe të marrjes në konsideratë si një individ me të drejta të patjetërsueshme. Zbatimi i një tërësie parimesh e rregullash, që i japin përparësi interesit të lartë të fëmijës e që vendosin në qendër fëmijën, është më se i domosdoshëm.

Parime të tjera bazë janë garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi, luftimi i paragjykimeve, diskriminimit dhe stereotipeve në shoqëri, vërtetësia dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

saktësia e konfirmuar e raportimit të ngjarjeve që lidhen me fëmijët, e drejta e pjesëmarrjes së fëmijëve si dhe parimi shumë i rëndësishëm që e vendos median në shërbim të fëmijëve.

Për realizimin dhe zbatimin e parimeve të mësipërme nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv duhet të mbahen parasysh rregullat që vijojnë:

Identifikimi i fëmijës

5.1 OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale.

5.2 Duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare.

5.3 Në rastet e parashikuara në pikat 5.1 dhe 5.2 më sipër, duhet përdorur teknologjia e përshtatshme që mundëson fshehjen e identitetit me pamje ose zë të fëmijës

5.4 Kujdes duhet treguar edhe me raportimin e transmetimin e palëve të treta jo-fëmijë, kur kjo mund të çojë në identifikimin direkt ose indirekt të fëmijës sipas pikave 6.1 dhe 6.2 të sipër përmendura.

5.5 Pamjet apo imazhet e fëmijëve duhen marrë në mënyrë të ndershme dhe të drejtë dhe kurdo që është e mundur, ato duhen marrë me dijeninë dhe pëlqimin e vetë fëmijës dhenë rast të kundërt ato duhen marrë me pëlqimin e prindërve të tij ose kujdestarit ligjor të fëmijës, pasi t'iu jetë shpjeguar qëllimi.

5.6 OSHMA-të duhet të shmangin transmetimin e fotove dhe imazheve degraduese të fëmijëve dhe në vend të tyre duhet stimuluar transmetimi i fotove dhe imazheve pozitive të fëmijëve.

5.7 Duhet shmangur botimi dhe transmetimi i çdo fotoje dhe imazhi fëmije me nuancë seksuale apo që paraqet fëmijën në pozicione të papërshtatshme.

5.8 Filmimi i fëmijëve duhet kryer në mjedise publike ose në praninë e përfaqësuesit ligjor të fëmijës ose një personi të caktuar prej tij.

5.9 OSHMA-të duhet të kenë rregulla të forta për arkivimin dhe shpërndarjen e materialeve dhe filmimeve me fëmijë, duke kufizuar dhe parandaluar mundësitë e abuzimit me këto materiale. Materialet që blihen OSHMA –të (dokumentar, etj) respektojnë për sa është e mundur sa më sipër.

Intervistimi fëmijës

5.10 Intervistimi i fëmijëve duhet të bëhet me praninë ose të paktën me dijeninë e përfaqësuesit të tij ligjor ose një personi të caktuar prej tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

5.11 Fëmijës si dhe përfaqësuesit ligjor duhet t'i shpjegohet paraprakisht qëllimi i intervistës, si dhe përdorimi i mundshëm i saj. Si për fëmijën, ashtu edhe për përfaqësuesin ligjor, duhet të respektohet e drejta e tyre për të mos pranuar të intervistohen.

5.12 Në rast se përfaqësuesi ligjor refuzon intervistimin e fëmijës, intervistimi mund të kryhet vetëm nëse fëmija insiston të intervistohet dhe gazetari ka një arsye konkrete të mendojë që intervistimi i shërben interesit të fëmijës

5.13 Në asnjë rast gazetari nuk ushtron presion, bën premtime apo jep dhurata fëmijës apo përfaqësuesit të tij ligjor me qëllim mundësimin e intervistimit.

5.14 Nëse është e nevojshme, gjatë intervistimit të fëmijës, gazetari mund të kërkojë asistencën e një psikologu apo punonjësi social të specializuar.

5.15 Intervista duhet të zhvillohet në një mjedis të përshtatshëm ku fëmija ndihet i lirë dhe jo nën presion. Duhet të shmangen intervistimet dhe filmimet e gjata që lodhin dhe ndikojnë negativisht tek fëmijët si dhe përsëritja pa arsye të forta e intervistimit dhe filmimit të të njëjtit fëmijë.

5.16 Pyetjet duhet të jenë të qarta dhe të drejtpërdrejta dhe nuk duhet t'i sugjerojnë përgjigjen fëmijës.

5.17 Duhet të shmangen pyetjet ose komentet paragjyquese, të rrezikshme për fëmijën, ose ato që i sjellin ndërmend ngjarje traumatike.

5.18 Fëmijët nuk duhet të detyrohen të sillen sipas udhëzimeve të dhëna nga gazetari ose media, ata duhen nxitur vetëm të jenë vetvetja.

5.19 Nëse gjatë intervistimit gazetari vihet në dijeni për një vepër penale të kryer ndaj fëmijës apo që rrezikon fëmijën, gazetari duhet të njoftojë menjëherë organet përkatëse.

5.20 Në rast se gjatë intervistimit gazetari vihet në dijeni për fakte, bërja publike e të cilave mund të rrezikojnë jetën, shëndetin apo mirëqenien e fëmijës, intervista apo kjo pjesë e saj nuk duhet të transmetohet.

Reklamat dhe fëmijët

5.21 OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë reklama që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve.

5.22 OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë në programet për fëmijë reklamat e kategorive të veçanta të ushqimeve dhe pijeve që konsiderohen se janë të dëmshme për të miturit, veçanërisht ato me përmbajtje të lartë yndyre, sheqeri, kripe etj.

5.23 OSHMA-të duhet të kontrollojnë përmbajtjen e reklamave dhe promocionit të programeve,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

sidomos të reklamave me dhe për fëmijët.

5.24 Reklammat nuk duhet t'i paraqesin fëmijët në situata e qëndrime të dhunshme e të rrezikshme, agresive apo auto agresive.

5.25 Reklammat nuk duhet të paraqesin fëmijë duke konsumuar alkool, duhan apo substanca të tjera të dëmshme.

5.26 Fëmijët nuk duhet të paraqiten drejtpërdrejt në blerjen e produkteve që reklamohen, pasi mund të abuzohet me besimin dhe mungesën e përvojës së tyre.

5.27 OSHMA-të duhet të hartojnë dhe zbatojnë kode sjelljeje lidhje me komunikimet e papërshtatshme me natyrë tregtare në transmetimet e tyre.

Programet kulturore argëtuese, filmat dhe fëmijët.

5.28 OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor, ose moral të të miturve, në veçanti filma apo programe që përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale.

5.29 OSHMA-të, në programet kulturore e argëtuese, veçanërisht në paraqitjen e sjelljeve të dhunshme dhe seksuale, duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të të miturve.

5.30 OSHMA-të duhet të planifikojnë në fasha orare të përshtatshme programe të posaçme kulturore argëtuese për fëmijët.

5.31 OSHMA-të, duhet të zbatojnë me përpikëri kërkesat etike – morale dhe të mbrojnë të drejtat e fëmijëve në programet kulturore argëtuese për fëmijë.

5.32 OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. (Ora kufi 21.00 –06.00)

5.33 Kur programe me përmbajtje që mund të dëmtojë fëmijët transmetohen në formë të hapur ato duhet të paraprihen nga një paralajmërim akustik ose të identifikohen nga prezenca e një simboli viziv gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre.

5.34 OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh shkallën e dëmit së shkaktuar nga paraqitja e ndonjë lloj materiali që dëmton fëmijët, në programe përgjithësisht ose në programe të një natyre të caktuar.

5.35 OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh kërkesat e fëmijëve ndaj transmetimeve audiovizive në sasi e cilësi, si për të shmangur rrezikun e varësisë së fëmijës ndaj televizionit ashtu edhe për të mos imituar modelet televizive.

5.36 OSHMA-të duhet të trajtojnë me respekt, dinjitet e profesionalizëm të gjithë fëmijët që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

marrin pjesë në programet audiovizive.

5.37 OSHMA-të nuk duhet të lejojnë, në programet e tyre, përdorimin e fëmijëve me probleme patologjike apo me aftësi të kufizuara për qëllime propagandistike apo për çdo qëllim tjetër që abuzon me të drejtat e tyre, përveçse për qëllime në interes të fëmijëve dhe me miratimin e përfaqësuesit ligjor.

5.38 OSHMA-të janë të detyruara të vendosin shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht në filmat dhe programet me përmbajtje e skena problematike.

5.39 OSHMA-të duhet të tregojnë kujdes të veçantë për gjuhën dhe komunikimin etik në programet argëtuese, në spektaklet e organizuara me dhe për fëmijët.

5.40 OSHMA-të, në rastin e Shërbimeve Mediatike Audiovizive në bazë të kërkesës (on demand), duhet të transmetojnë në formë të koduar programet që mund të dëmtojnë rëndë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, kodim që duhet të sigurojë mos marrjen e tyre nga të miturit në kushte të zakonshme.

5.41 Në programet kulturore e argëtuese për fëmijët nuk duhet të përdoren terma të cilat nxisin qëndrime paragjyquese.

Shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve në programet audiovizive

5.42 Për programet që transmetohen në fashën orare 19.00 – 22.30, bëhet i detyrueshëm përdorimi i shenjave paralajmëruese për programet që cenojnë e dëmtojnë fëmijët.

5.43 OSHMA-të duhet të transmetojnë programet e përcaktuara në pikën 5.41 më sipër, me shenjën përkatëse, e cila duhet të shfaqet në ekran në një vend të dukshëm, me ngjyrë të qartë e të dallueshme.

5.44 OSHMA-të duhet të përgatisin transmetimin e filmave apo programeve të përcaktuara në pikën 5.41 me shenjën përkatëse (kur programi vetë nuk e përcakton) duke u mbështetur në vizionimim paraprak të programit, sipas kriterëve, standardeve e rregullave të Kodit të Transmetimit.

5.45 Shfaqja e shenjës paralajmëruese në ekran bëhet menjëherë me fillimin e programit apo filmit dhe e shoqëron atë gjatë gjithë kohës së transmetimit. Shenja paralajmëruese rishfaqet para dhe pas të gjitha ndërprerjeve të programit në vijim, deri në përfundim të tij.

5.46 Llojet e shenjave paralajmëruese, që do të përdoren nga OSHMA-të do të jenë tre:

- A. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të kuqe, për programe ose filma, që nuk duhet të ndiqen nga fëmijët, të cilat transmetohen vetëm pas orës 21.00, me skena të rënda dhune psikologjike e fizike, me skena seksi, me keqpërdorim të gjuhës, fjalorit dhe etikës së komunikimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- B. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të verdhë, për programe ose filma, të cilat fëmijët duhet t'i ndjekin të shoqëruar nga të rriturit.
- C. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të gjelbër, për programe ose filma me përmbajtje që mund të ndiqen nga të gjithë, përfshi edhe fëmijët.

5.47 OSHMA-të mund të përdorin forma të ndryshme të zgjidhjes grafike për shenjat paralajmëruese, por ngjyra dhe qartësia e shenjës janë elementë të pandryshueshëm dhe të detyrueshëm për të gjithë.

SEKSIONI 6 PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE

6.1 OSHMA-të duhet të luajnë një rol të rëndësishëm për të dhënë një imazh të respektuar të personave me aftësi të kufizuar në transmetimet audiovizive.

6.2 OSHMA-të kanë për detyrë të tërheqin vëmendjen dhe të sensibilizojnë shoqërinë dhe institucionet e ndryshme për përgjegjësinë ndaj personave me aftësi të kufizuar.

6.3 OSHMA-të duhet të promovojnë përpjekjet e shoqatave dhe personave me aftësi të kufizuar për integrimin e tyre në jetën shoqërore.

6.4 OSHMA-të duhet të sigurojnë trajtim të drejtë dhe objektiv të personave me aftësi të kufizuar në programet e tyre: jo mëshirë, as denigrim, por vlerësim dhe inkurajim.

6.5 OSHMA-të nuk duhet të lejojnë përdorimin e imazhit të personave me aftësi të kufizuar për publicitet apo reklama, përveçse për fushatat sensibilizuese dhe me ndikim në favor të këtyre personave.

6.6 Transmetimet audiovizive nuk duhet të paragjykojnë, të përdorin apo të identifikojnë persona me aftësi të kufizuar, për të mos dëmtuar interesat dhe të drejtat e tyre.

6.7 OSHMA-të nuk duhet të shfrytëzojnë ndjeshmërinë e publikut ndaj personave me aftësi të kufizuar për përfitime apo qëllime komerciale.

6.8 OSHMA-të duhet t'i trajtojnë me etikë maksimale pamjet e personave me aftësi të kufizuara: s' duhet të paraqiten me detaje gjymtimet e tyre dhe fjalori i gazetarëve duhet të respektojë dinjitetin e tyre.

6.9 OSHMA-të duhet të marrin masa për të siguruar që shërbimet e tyre të jenë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuar. OSHMA-të duhet të nxisin promovimin e arritjeve të personave me aftësi të kufizuar.

SEKSIONI 7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

PROMOVIMI I VEPRAVE EUROPIANE DHE VEPRAVE TË PAVARURA

- 7.1 OSHMA-të duhet të njohin dhe të dallojnë përcaktimet e neneve 35 dhe 36 të ligjit nr. 97/2013 për veprat evropiane, si dhe për veprat e prodhuesve të pavarur.
- 7.2 OSHMA-të duhet të promovojnë prodhimin dhe transmetimin e veprave evropiane dhe aksesin ndaj këtyre veprave. Promovimi, ndërmjet të tjerave, mund të kryhet, përmes kontributeve financiare për prodhimin dhe blerjen e të drejtave të veprave evropiane ose duke garantuar një vend për transmetimin e punëve evropiane në katalogun e programeve të transmetuara prej tyre.
- 7.3 OSHMA-të kombëtare duhet të rezervojnë shumicën e kohës së tyre të transmetimit për veprat evropiane, duke përfshirë kohën e caktuar për lajmet, ngjarjet sportive, lojrat, reklamat, shërbimet e teletekstit dhe teleshitjet.
- 7.4 OSHMA-të kombëtare duhet të rezervojnë të paktën 10% të kohës së tyre të transmetimit për prodhimet e pavarura, duke përfshirë kohën e caktuar për lajmet, ngjarjet sportive, lojrat, reklamat, shërbimet e teletekstit dhe teleshitjet.
- 7.5 OSHMA-të mund të nxisin dhe të marrin pjesë përmes bashkëpunimit të drejtpërdrejtë në prodhimin, blerjen dhe transmetimin e veprave evropiane, mbështetur në kontratat përkatëse.
- 7.6 Blerja e të drejtave të punëve (veprave) evropiane nga OSHMA-të duhet të bëhet duke respektuar të drejtat e autorit dhe të drejtat e pronësisë intelektuale.
- 7.7 Bashkëpunimi dhe më pas transmetimi nga OSHMA-të i veprave të prodhuesve të pavarur duhet të bëhet mbi bazën e respektimit të kërkesave të këtij Kodi për programet kulturore, reklamat, filmat etj.

**SEKSIONI 8
REKLAMAT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE**

- 8.1 Transmetimi i reklamave nga OSHMA-të duhet të mbajë parasysh kërkesat ligjore, veçanërisht për reklamat e ndaluara si dhe reklamat e fshehura.
- 8.2 OSHMA-ve u ndalohet të përdorin gjatë transmetimit të reklamave, mënyra të joshjes së shikuesve në mënyrë të pandërgjegjshme dhe teknika për sugjestionimin e tyre që ndikojnë negativisht teleshikuesit.
- 8.3 OSHMA-të nuk duhet të pranojnë apo të transmetojnë reklama që nxisin diskriminimin hapazi apo në mënyrë të nënkuptuar, që nuk respektojnë dinjitetin dhe të drejtat e njeriut, sidomos të drejtat e grave dhe fëmijëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- 8.4 Reklammat nuk duhet të nxisin apo të shtyjnë të miturit të blejnë apo të marrin prodhime ose shërbime, duke i nxitur drejtpërsëdrejti për të kërkuar nga prindërit ose të tjerë persona të afërm t'u marrin mallrat apo shërbimet e reklamuar, ose të shfrytëzojnë pozitën e fëmijëve në raport me prindërit, mësuesit ose persona të tjerë të afërm të tyre.
- 8.5 Ndërprerjet për komunikimet me natyrë tregtare në programe të ndryshme duhet të respektojnë kohën e përcaktuar për reklamë në raport me programet e tjera, si dhe duhet të respektojnë normat dhe kërkesat e etikës së komunikimit.

SEKSIONI 9
KËSHILLI I ANKESAVE

- 9.1. Këshilli i Ankesave mbikëqyr zbatimin e Kodit të Transmetimit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, për çdo subjekt veprimtaria e të cilit rregullohet nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë". Objekti i punës së Këshillit të ankesave përfshin sidomos respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive.
- 9.2. Këshilli i Ankesave ndjek në mënyrë periodike masën, në të cilën programet e një transmetuesi të huaj, të cilët tërësisht ose kryesisht u drejtohen spektatorëve në Republikën e Shqipërisë ekskluzivisht për qëllime informative, përputhen me Kodin e Transmetimit.
- 9.3. Këshilli i Ankesave shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve, respektimin e të drejtave të njeriut, rregullat e etikës, fshehtësinë e jetës private, mostransmetimin e programeve pornografike pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror.
- 9.4. Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë.
- 9.5 Këshilli i Ankesave, kur e çmon të nevojshme, ia kalon ankesën e paraqitur OSHMA- së për të paraqitur pretendimet e veta brenda 7ditëve.
- 9.6 OSHMA-ja transmeton konkluzionin e Këshillit të Ankesave, kur ky konkluzion është në favor të personit që ka kryer ankesën, brenda 2 ditëve nga marrja e njoftimit, në një mënyrë të njëjtë me atë të realizimit të transmetimit, kundrejt të cilit është bërë ankesa.
- 9.7 Këshilli i Ankesave vendos lidhur me zgjidhjen e ankesës brenda një afati 15-ditor. Gjatë procedurave të zgjidhjes së ankesës, Këshilli i Ankesave mund të vendosë organizimin e seancave dëgjimore me palët.
- 9.8 Kur një çështje ka qenë objekt i shumë ankesave të paraqitura, në bazë të këtij neni, ose për transmetime, që janë jashtë juridiksionit territorial të AMA-s, Këshilli i Ankesave, në qoftë se e konsideron të përshtatshme, i raporton AMA-s, lidhur me aspektet e saj dhe mënyrat e zgjidhjes.
- 9.9 Pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të subjektit, Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shkelje, i propozon AMA-s masat përkatëse. Në çdo rast Këshilli i Ankesave njofton



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- me shkrim personin që ka paraqitur ankesën dhe OSHMA-në përkatëse mbi konkluzionet dhe masat.
- 9.10 Këshilli i Ankesave, me ekspertizë të pavarur, mund të organizojë anketime të publikut për problemet etike të programeve. Përfundimet që nxjerr nga studimi i anketimeve dhe nga ankesat e publikut ia raporton AMA-s, duke sugjeruar masat për përmirësim. Përfundimet mund të publikohen edhe në mjetet e informimit publik.
- 9.11 Çdo 6 muaj Këshilli i Ankesave boton një përmbledhje të përfundimeve të nxjerra, në bazë të pikës 9.4 më sipër, në një buletin të veçantë që botohet nga AMA.
- 9.12 Këshilli i Ankesave përcakton udhëzimet mbi bazën e të cilave duhet të veprojnë OSHMA-ja për shqyrtimin e ankesave të paraqitura me shkrim nga çdo person për programet e transmetuara prej tij, lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 33 ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
- 9.13 Këshilli i Ankesave ka të drejtë të kryejë inspektimin e regjistrimeve të ankesës dhe përgjigjeve të tyre, të cilat janë mbajtur nga subjekti veprimtaria e të cilit rregullohet nga ligji nr. 97/2013, gjatë një periudhe kohore prej dy vjetësh nga data e regjistrimit të ankesës.
- 9.14 Këshilli i Ankesave, kur e çmon të nevojshme, ia kalon ankesën e paraqitur OSHMA- së për të paraqitur pretendimet e veta brenda 7ditëve.
- 9.15 OSHMA-ja transmeton konkluzionin e Këshillit të Ankesave, kur ky konkluzion është në favor të personit që ka kryer ankesën, brenda 2 ditëve nga marrja e njoftimit, në një mënyrë të njëjtë me atë të realizimit të transmetimit, kundrejt të cilit është bërë ankesa.
- 9.16 Këshilli i Ankesave vendos lidhur me zgjidhjen e ankesës brenda një afati 15-ditor. Gjatë procedurave të zgjidhjes së ankesës, Këshilli i Ankesave mund të vendosë organizimin e seancave dëgjimore me palët.
- 9.17 Kur një çështje ka qenë objekt i shumë ankesave të paraqitura, në bazë të këtij neni, ose për transmetime, që janë jashtë juridiksionit territorial të AMA-s, Këshilli i Ankesave, në qoftë se e konsideron të përshtatshme, i raporton AMA-s, lidhur me aspektet e saj dhe mënyrat e zgjidhjes.
- 9.18 Pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të subjektit, Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shkelje, i propozon AMA-s masat përkatëse. Në çdo rast Këshilli i Ankesave njofton me shkrim personin që ka paraqitur ankesën dhe OSHMA-në përkatëse mbi konkluzionet dhe masat.
- 9.19 Këshilli i Ankesave, me ekspertizë të pavarur, mund të organizojë anketime të publikut për problemet etike të programeve. Përfundimet që nxjerr nga studimi i anketimeve dhe nga ankesat e publikut ia raporton AMA-s, duke sugjeruar masat për përmirësim. Përfundimet mund të publikohen edhe në mjetet e informimit publik.
- 9.20 Çdo 6 muaj Këshilli i Ankesave boton një përmbledhje të përfundimeve të nxjerra, në bazë të pikës 9.4 më sipër, në një buletin të veçantë që botohet nga AMA.
- 9.21 Këshilli i Ankesave përcakton udhëzimet mbi bazën e të cilave duhet të veprojnë OSHMA-ja për shqyrtimin e ankesave të paraqitura me shkrim nga çdo person për programet e transmetuara prej tij, lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 33 ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

9.22 Këshilli i Ankesave ka të drejtë të kryejë inspektimin e regjistrimeve të ankesës dhe përgjigjeve të tyre, të cilat janë mbajtur nga subjekti veprimtaria e të cilit rregullohet nga ligji nr. 97/2013, gjatë një periudhe kohore prej dy vjetësh nga data e regjistrimit të ankesës.